

LIGJ
Nr.8313, datë 26.3.1998
PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL
(Ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000; nr. 8842, datë 11.12.2001)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Subjektet e tatimit të biznesit të vogël
(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000)

Subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë çfarëdo periudhe të vitit kalendarik, i cili realizon një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.

Objekt i tatimit mbi biznesin e vogël është xhironja (në lekë) e realizuar në çdo vend biznesi për një vit kalendarik.

Tatimi mbi biznesin e vogël nënkupton tatimin me kuotë fikse, të llogaritur sipas tabelës përkatëse të kreut II, plus tatimin mbi xhiron të llogaritur sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji.

Neni 2

Përkufizime

a) Termi “Person” nënkupton çdo person fizik ose juridik, shtetëror ose privat, shqiptar ose i huaj që kryen veprimtari biznesi.

b) Termi “Tatimpagues” nënkupton çdo person që i nënshtrohet tatimit sipas këtij ligji.

c) Termi “Tatim” nënkupton tatimin mbi biznesin e vogël të përcaktuar nga ky ligj. Ai përbëhet nga tatimi me kuotë fikse dhe tatimi mbi xhiron.

ç) Termi “Tatim me kuotë fikse” nënkupton tatimin e përcaktuar nga kreu II.

d) Termi “Tatim mbi xhiron” nënkupton tatimin e përcaktuar nga kreu III.

dh) Termi “Biznes” nënkupton çdo veprimtari ekonomike të kryer për qëllime fitimi.

e) Termi “Xhiro” nënkupton të ardhurat në lekë të arkëtuara nga shitja e mallrave apo shërbimeve të kryera për çdo vend biznesi. Xhironja llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi për mallrat apo shërbimet që blen.

ë) Termi “Vend biznesi” nënkupton çdo dyqan, njësi të veçantë ose vend tjetër fiks ku ushtrohet biznes.

f) Termi “Udhëzim” nënkupton udhëzimin e lëshuar nga ministri i Financave në zbatim të këtij ligji.

KREU II TATIMI ME KUOTË FIKSE

Neni 3

(Ndryshuar paragrafi i parw me ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001)

Subjekte të tatimit me kuotë fikse janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2 000 000 lekë në vit.

1. Tatimi me kuotë fikse (në mijë lekë në vit)

Lloji i biznesit	Kategoria I	Qytetet Kategoria II	Kategoria
III			
A. Tregti me pakicë			
1. Tregti në njësi e dyqane	80	40	30
2. Dyqane mode (boutique) e Parfumeri	150	80	60
3. Dyqane bizhuterie, argjendarie e floriri	200	80	70
B. Prodhim			
1. Duralumini, druri, tapiceri	150	60	50
2. Bulmet, ëmbëlsirë e të tjera të ngjashme me to	120	60	50
3. Prodhime brumi	70	60	50
C. Riparime			
1. Riparim artikujsh elektro-shtëpiakë, radio, televizorë e të tjera të ngjashme me to	60	30	20
Ç. Shërbime			
1. Fotografim-zhvillim-stampim e fotokopjim	100	60	50
2. Disko, sallone bukurie, autoservise, autoshkolla, agjenci të ndryshme, parkingje makinash, kurse kompjuteri, salla lojërash, shtypshkrime e të tjera të ngjashme me to	100	60	50
3. Bar-bufe, kafe-internet	100	60	50
4. Restorant	200	70	50
5. Motel	150	60	50
6. Bar-bufe në dikasteret dhe institucionet shtetërore	60	40	30
7. Bilardo (për një tavolinë)	45	30	30
D. Profesione			
1. Avokat, noter	150	70	60
2. Klinikë specialitetesh	200	70	60

3.Shërbime stomatologjike individuale, shërbime laboratorit individuale dhe farmaci individuale	90	60	40
---	----	----	----

4.Ekonomist kontabël i miratuar, ekspert kontabël i autorizuar, mësues, veteriner, agronom, përkthyes e profesione të tjera	70	60	50
--	----	----	----

5. Inxhinier arkitekt, projektues,	200	50	40
------------------------------------	-----	----	----

6. Studio arti dhe galeri	35	30	25
---------------------------	----	----	----

7. Shkolla jopublike	110	90	70
----------------------	-----	----	----

DH. Ambulant, artizanat

1.Tregti ambulante	15	10	10
--------------------	----	----	----

2. Artizanë të vegjël si: bojaxhi, hidraulik, elektricitist, lustraxhi, këpucar, marangoz, pemëtar, berber, zëtorist, kombajner, llamarinist laborant, murator, teneqepunues, riparim bikikletash e të tjera të ngjashme me to	15	10	10
--	----	----	----

3. Floktore, rrobaqepësi	15	10	10
--------------------------	----	----	----

4.Në tregje të miratuara nga bashkia për shitje me pakicë fruta-perime dhe mallra të përdorura	15	10	10
--	----	----	----

E. Transport

Për transportin e udhëtarëve:

në vit.	Automjete deri në 5 vende, duke përfshirë edhe shoferin	30 mijë lekë
---------	---	--------------

në vit.	Automjete nga 6-9 vende, duke përfshirë edhe shoferin	70 mijë lekë
---------	---	--------------

	Automjete nga 10-25 vende	90 mijë lekë në vit.
--	---------------------------	----------------------

	Automjete nga 26-42 vende	90 mijë lekë në vit.
--	---------------------------	----------------------

	Automjetet mbi 42 vende	95 mijë lekë në vit.
--	-------------------------	----------------------

Për transportin e mallrave:

	Automjete deri në 2 tonë	55 mijë lekë në vit.
--	--------------------------	----------------------

	Automjete nga 2,1-5 tonë	80 mijë lekë në vit.
--	--------------------------	----------------------

	Automjete nga 5,1-10 tonë	95 mijë lekë në vit.
--	---------------------------	----------------------

vit.	Automjete nga 10,1-16 tonë	100 mijë lekë në vit.
------	----------------------------	-----------------------

lekë në vit.	Automjete mbi 16 tonë	150 mijë lekë në vit.
--------------	-----------------------	-----------------------

Për transportin ujor:

vit.	Transport detar i brendshëm	110 mijë lekë në vit.
------	-----------------------------	-----------------------

	Transport ujor në liqene	95 mijë lekë në vit.
--	--------------------------	----------------------

Varka në shërbim të pushuesve

30 mijë lekë në vit.

2. Ndarja e qyteteve sipas kategorive

Në kategorinë I : Tirana dhe Durrësi.

Në kategorinë II : Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati dhe Kavaja.

Në kategorinë III : Të gjitha qytetet e tjera.

3. Kur veprimtaritë që përfshihen në pikat A, B, C, Ç, D, DH, E ushtrohen në fshat, kuotat fikse të tatimit janë sa gjysma e kuotave përkatëse në tabelë.

4. Kur veprimtaria e biznesit fillon në një muaj çfarëdo të vitit, atëherë masa e tatimit vjetor llogaritet duke shumëzuar kuotën fikse të tatimit në tabelë me raportin (thyesën) që si numërues ka numrin e muajve të mbetur të vitit (përfshirë muajin e regjistrimit), kurse si emërues ka numrin 12 të muajve të vitit. Kjo mënyrë llogaritjeje përdoret edhe në rastet e ndërprerjes së përkohshme ose mbylljes së veprimtarisë.

Neni 4

Regjistrimi dhe detyrimet ndaj tij

1. Çdo person që kërkon të fillojë një biznes, duhet të regjistrohet në zyrën e tatimeve të rrethit ku ai e ushtron veprimtarinë e tij.

2. Personi që regjistrohet duhet të plotësojë deklaratën përkatëse me këto të dhëna :

a) Emri e mbiemri (sipas dokumentit identifikues)

b) Vendimi i gjykatës që i njeh zotësinë tatimpaguesit për të ushtruar biznes;

c) Lloji ose llojet e biznesit që do të ushtrojë

ç) Adresa e vendit a vendeve të biznesit

d) Xhiro e realizuar gjatë vitit të mëparshëm

dh) Xhiro e parashikuar për vitin në vijim

e) Informacione të tjera mbi biznesin që i kërkojnë sipas udhëzimit të ministrit të Financave.

3. Organet tatimore pajisin me “Çertifikatë regjistrimi” çdo person të regjistruar. Përmbajtja e saj përcaktohet në udhëzim.

4. Personi që ushtron në vijimësi biznes, duke qenë subjekt i tatimit, është i detyruar të reregjistrohet me fillimin e vitit kalendarik, brenda muajit shkurt të çdo viti.

5. Kur një person ushtron biznes në dy ose më shumë vende biznesi, ai do të pajiset për secilin vend biznesi me çertifikatë regjistrimi, ku të evidentohet lloji i biznesit. Personi i regjistruar do të ketë të njëjtin kod tatimor për të gjitha vendet e biznesit të tij.

6. Kur tatimpaguesi nuk ushtron biznes në një vend fiks, atëherë:

a) në rastin e një personi fizik, regjistrimi bëhet në zyrën e tatimeve të rrethit ku banon;

b) në rastin e një personi juridik, regjistrimi bëhet në zyrën e tatimeve të rrethit ku banon pronari kryesor.

7. Kur tatimpaguesi nuk ushtron biznes në një vend fiks (ambulant) ose merret me shërbime transporti, ai lejohet ta ndërpresë përkohësisht dy herë në vit veprimtarinë e tij për shkaqe të përcaktuara në udhëzim për periudha jo më pak se 30 ditë.

8. Tatimpaguesi është i detyruar të informojë zyrën e tatimeve me shkrim brenda 15 ditëve për çdo ndryshim të mundshëm që lidhet me deklaratimet e tij të dhëna për regjistrim si emri, adresa, vendi i biznesit etj.

9. Tatimpaguesi duhet ta ekspozojë çertifikatën e regjistrimit të dhënë nga organi tatimor në një vend të dukshëm, ku ai ushtron biznes. Në rast se tatimpaguesi ushtron biznes në dy a më shumë vende, ai duhet të ekspozojë në secilin vend biznesi çertifikatën e regjistrimit.

KREU III TATIMI MBI XHIRON

Neni 5

Tarifa e tatimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000)

Tatimi mbi xhiron për tatimpaguesit që realizojnë shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë, për çdo vit kalendarik, është 4 për qind e xhiros.

Neni 6

Deklarimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000)

Deklarimi me shkrim i xhiros nga tatimpaguesi, për shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, bëhet deri më 28 shkurt të vitit pasardhës.

Gjatë vitit, organet tatimore detyrohen të vërtetojnë vëllimin e xhiros së realizuar. Për këtë, ato kanë parasysh të dhënat nga arkat regjistruese, kuponat tatimore, librat e blerjes dhe të xhiros, të dhënat nga doganat, nga degët e thesarit etj., si dhe të dhënat e rezultuara nga fotografimet, kronometrimet, sipërfaqet prodhuese ose të shërbimit që ka tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit etj.

KREU IV REGJISTRIMI I VEPRIMEVE DHE PAGESAT

Neni 7

Regjistrimet, përdorimi i arkave regjistruese

(Ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000)

1. Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e xhiros. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron xhiron e realizuar çdo ditë. Xhiroja e realizuar gjatë ditës është shuma e shitjeve të realizuara, nëpërmjet kuponave tatimorë ose dëftesave tatimore të lëshuara.

Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e blerjeve. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron çdo ditë blerjet e bëra gjatë ditës. Shumat dhe blerjet ditore duhet të justifikohen me faturat tatimore të blerjeve (faturë e thjeshtë, e lëshuar nga tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël ose faturë me TVSH, e lëshuar nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH). Librin e blerjeve nuk janë të detyruar ta mbajnë tatimpaguesit e pikave “Dh. Profesione”; “E.Ambulant, artizanat” dhe “E.Transport” të nenit 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Libri i xhiros dhe libri i blerjeve sekretohen nga organi tatimor i rrethit përkatës.

2. Të gjithë tatimpaguesit e biznesit të vogël, të pajisur me arkë regjistruese, janë të detyruar të lëshojnë kuponin tatimor për çdo shitje të kryer.

Të gjithë tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arkë regjistruese ose megjithëse e kanë atë, por për shkaqe të parashikuara në ligj nuk e përdorin, janë të detyruar të lëshojnë dëftesë tatimore. Dëftesa tatimore lëshohet në çastin e furnizimit me mall ose të shërbimit të kryer dhe në rastet e parapagimit në çastin e marrjes së parapagesës.

Format e dëftesës tatimore përcaktohen nga Ministri i Financave.

3. Kuponat ose dëftesat tatimore të shitjes, faturat e blerjes, librat e xhiros dhe librat e blerjeve ruhen për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

4. Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të paraqesin të gjithë dokumentacionin e mësipërm, kur ai u kërkohet nga organet tatimore.

5. Tatimpaguesit janë të detyruar të afishojnë, në çdo rast, çmimin përfundimtar të mallit që shesin ose të shërbimit që kryejnë.

6. Tatimpaguesit janë të detyruar, për qëllime kontrolli, të lejojnë hyrjen e punonjësve të organeve tatimore në mjediset e biznesit.

Neni 8

Pagesa

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000)

1. Çdo njësi a dyqan ku ushtrohet biznes tatohet më vete. Tatimi me kuotë fikse paguhet në dy këste.

Në rast reregjistrimi, pagesa e kështit të parë bëhet me marrjen e certifikatës së regjistrimit deri në 28 shkurt dhe pagesa e kështit të dytë deri në 30 qershor. Për subjektet që çelin veprimtari në çfarëdo periudhë të vitit, kësti i parë, sipas tabelës, paguhet me regjistrimin (fillimin e veprimtarisë), kurse kësti i dytë deri në 15 dhjetor.

2. Kur tatimpaguesi e paguan tatimin me kuotë fikse njëherazi me marrjen e certifikatës, atëherë atij i bëhet zbritje e tatimit në masën 10 për qind.

3. Kur gjatë shqyrtimit të të dhënave shuma e tatimit në tabelë del më e lartë se kuota e derdhur paraprakisht, atëherë tatimpaguesi është i detyruar të paguajë diferencën.

4. Tatimi mbi xhiron, në masën 4 për qind, paguhet 2 herë në vit dhe, konkretisht, brenda muajit shtator paguhet kësti i parë dhe brenda muajit nëntor paguhet kësti i dytë.

5. Të dy tatimet paguhen në formën, mënyrën dhe vendin e përcaktuar në udhëzim.

6. Të dy tatimet paguhen për buxhetin e shtetit.

Neni 9

Përgjegjësia dhe shkeljet

(Ndryshuar shkronja "ç" e paragrafit të dytë me ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001)

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje:

a) Mosregjistrimi sipas kërkesave të përcaktuara në Kreun II.

b) Mosplotësimi i deklaratës siç është përcaktuar në Kreun III.

c) Mosnjoftimi i organeve tatimore për ndryshimin në emrin, adresën, vendin dhe llojin e biznesit etj.

ç) Mosekspozimi i certifikatës së regjistrimit sipas pikës 9 të nenit 4 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

d) Mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit nga tatimpaguesit ambulantë, kur ajo u kërkohet nga organi tatimor.

dh) Mospagimi i tatimit në afatet e caktuara.

e) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

ë) Moslëshimi i kuponit ose i dëftesës tatimore ose lëshimi i tyre me vlerë më të vogël se vlera reale.

f) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

g) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

gj) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 5 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

h) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

2. Për shkeljet e mësipërme jepen këto dënime:

a) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë deri në 50 mijë lekë.

b) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

c) Shkeljet e përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

ç) Shkeljet e parashikuara në shkronjat "e", "f" dhe "g" të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë, ndërsa shkeljet e parashikuara në shkronjën "ë" të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë 15 mijë lekë kur shkelja bëhet për herë të parë dhe 30 mijë lekë kur shkelja përsëritet.

d) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “gj” dhe “h” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën nga 10 mijë deri 20 mijë lekë.

Neni 10

Ligji nr.7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.2031, datë 1.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**